

VENDIM
Nr.401, datë 21.6.2006

PËR KOMPENSIMIN E TË ARDHURAVE MUJORE TË PENSIONISTËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të ardhurat mujore të pensionistëve, që marrin pensione të plota pleqërie, të caktuara në përputhje me dispozitat e ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë” dhe të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara, në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi, nuk mund të jenë më pak se 9 240 (nëntë mijë e dyqind e dyzet) lekë.

2. Në kuptim të këtij vendimi, të ardhurat mujore të pensionistit, përfshijnë masën e pensionit të pleqërisë, kompensimin, që jepet sipas vendimeve nr.138, datë 31.3.1994 të Këshillit të Ministrave, “Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse” dhe nr.471, datë 15.7.1996 të Këshillit të Ministrave “Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm”.

3. Kompensimi i të ardhurave mujore të pensionistit, deri në kufijtë e pikës 1, të këtij vendimi, të bëhet, si më poshtë vijon:

a) Pensionistëve, që marrin pensione, të plota dhe të pjesshme, pleqërie, të cilët para datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi, kanë të ardhura mujore nga 8 740 (tetë mijë e shtatëqind e dyzet) lekë deri në 9 239 (nëntë mijë e dyqind e tridhjetë e nëntë) lekë, t’u shtohet shuma fikse individuale deri në 500 (pesëqind) lekë në muaj.

b) Pensionistëve, që marrin pensione të pjesshme pleqërie, të cilët para datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi, kanë të ardhura mujore nën 8 740 (tetë mijë e shtatëqind e dyzet) lekë, t’u shtohet shuma fikse 500 (pesëqind) lekë në muaj.

4. Kompensimin shtesë për të ardhurat mujore, të shkronjave “a” e “b” të pikës 2, të këtij vendimi, e marrin edhe pensionistët, që datën e fillimit të pensionit e kanë në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi e në vazhdim, përfshirë edhe këtë datë.

5. Kompensimet e përfituara sipas këtij vendimi nuk do të jenë objekt ndryshimi, në rastet e rritjes së pensioneve, me vendime të Këshillit të Ministrave.

6. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi, për vitin 2006, në shumën 110 milionë lekë, të përballohen nga fond i kontigjencës, i caktuar në pikën 1/3 të nenit 12 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”.

7. Shpenzimet administrative për realizimin e këtij vendimi, që arrijnë vlerën 7.6 milionë lekë, të shtohen: në buxhetin e vitit 2006, miratuar për ISSH-në dhe të përballohen nga fondi i kontigjencës, të caktuar në pikën 1/3 të nenit 12 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin Shtetit të vitit 2006”.

8. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare, sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.11.2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha